



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit**

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**

**MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË**  
**ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, KOMISIONIT TË QENDRËS SË**  
**VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT**  
**DHE VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, TË KZAZ-SË**  
**NR. 88, PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, QARKU**  
**VLORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë.

Referuar përcaktimeve të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë për KQV-të.

Në zbatim të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor, është hartuar projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Kodi Zgjedhor, në nenin 103, pika 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:



- vula e KQV-së: “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;
- vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;
- vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së, dhe vulat rezervë për Komisionet e Qendrave të Votimit, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 6.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar.

Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten:

- lidhja 1, formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së;
- lidhja 2, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 3, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 4, formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

**Danjela Alimemeti – Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit**

**Madalena Koja – Drejtorja e Ligjshmërisë**

**Majlinda Çelmeta – Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

V E N D I M  
P Ë R

**MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, TË KZAZ-SË NR. 88, PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

- Miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që do të përdorë administrata zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024, si më poshtë:
  - vula e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi,
  - vula e Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi,
  - vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
  - vula rezervë për Komisionin e Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Sasia e vulave rezervë që do të prodhohet do të jetë 5 (pesë) copë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: dd mm vvvv Nr: .....  
Ora: hh:mm



“Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, të KZAZ-së nr. 88, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.

1. Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024
2. Formati i Vulës: KZAZ



**Legjenda:**

3. Diametri = 38 mm
4. Stema e Republikës së Shqipërisë
5. tekst: Republika e Shqipërisë
6. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
7. Numri i identifikimit: KZAZ-NR-XX.
8. tekst: Zgjedhjet Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024

Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024:

Formati i Vulës: KQV



**Legjenda:**

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. tekst: Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit
7. tekst: Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Formati i Vulës: Kryetari i KQV-së



**Legjenda:**

1. Gjatësia = 50 mm
2. Gjerësia = 25 mm
3. Stema e Republikës së Shqipërisë
4. tekst: Republika e Shqipërisë
5. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
6. KRYETARI
7. Numër serial pesëshifror: XXXXX
8. tekst: Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Formati i Vulës: KQV - rezervë



Legjenda:

Diametri = 38 mm

Stema e Republikës së Shqipërisë

tekst: Republika e Shqipërisë

tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

tekst: Komisioni i Qendrës së Votimit

Numri i identifikimit

tekst: REZERVË

tekst: Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024